



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 24.12.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 118/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas Kërkesës për ri-shqyrtim të datës 23.12.2020, të parashtruar nga "GRUPI I OE INTRAST SH.P.K. DHE SH. DRINI COMPANY SH.P.K." lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i Parkingjve në Qytet", me Nr. të Prok: 632-20-7438-5-2-1, nxjerr:

VENDIM

1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e "GRUPI I OE INTRAST SH.P.K. DHE SH. DRINI COMPANY SH.P.K." e dates 23.12.2020, lidhur me aktivitetin e "Ndërtimi i Parkingjve në Qytet", me Nr. të Prok: 632-20-7438-5-2-1, kundër **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, te AK –së, të datës 18.12.2020, të publikuar në platformën elektronike të KRPP.
2. Anulohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë 18.12.2020;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të ri vlerësojë aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

Arsyetim

GRUPI I OE INTRAST SH.P.K. DHE SH. DRINI COMPANY SH.P.K. me datë 23.12.2020, ka parashtruar Kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i Parkingjeve në Qytet", me Nr. të Prok: 632-20-7438-5-2-1,

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 24.12.2020, ka shqyrtuar Kërkesën në fjalë si më poshtë:

1. Në lidhje me pretendimin ankimor nr. 1 se Grupi i OE JOOS & KRASNIQI -BAZE SH.P.K.; N.P.N. " VIZION-PLUS dhe Grupi i OE N.SH.T. VIKTORY COM ; Marisa SH.P.K nuk kanë ofruar certifikatat EN 12675 dhe EU EN 12352 dhe EN 12899-1007 Class RA1-Certifikata, AK sqaron se që të dy OE nuk kanë ofruar këto dokumente andaj kjo pikë e ankesës është e bazuar.

2. Në lidhje me pretendimin ankimor nr. 2 se është kërkuar në sqarimet e dhëna me datë 07.12.2020 që të ofrohen dëshmi konform sqarimit dhe se asnjëri nuk kanë ofruar dëshmi sipas sqarimit, AK sqaron se OE ankues nuk ka saktësuar se cili OE ofertues nuk ka ofruar dëshminë e tillë andaj kjo pikë e kërkesës është e pabazuar.

3. Në lidhje me pretendimin ankimor nr. 3 se asnjëra ndër OE BERISHA COM, Grupi i OE JOOS & KRASNIQI -BAZE SH.P.K.; N.P.N. " VIZION-PLUS dhe Grupi i OE N.SH.T. VIKTORY COM ; Marisa SH.P.K nuk kanë dorëzuar katalogje dhe certifikata konform dosjes së tenderit, AK sqaron se OE BERISHA COM dhe Grupi i OE JOOS & KRASNIQI -BAZE SH.P.K.; N.P.N. " VIZION-PLUS nuk kanë dorëzuar kërksat konform sqarimit të datës 07.12.2020 si dhe Grupi i OE N.SH.T. VIKTORY COM ; Marisa SH.P.K ka ofruar disa dokumente të do të rishikohen gjatë procesit të ri vlerësimit të ofertave andaj kjo pikë e ankesës është e pjesërisht e bazuar.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve nga publikimi i Vendimit në platformën elektronike <https://e-prokurimi.rks-gov.net/>**

Kopje: Grupi i OEt Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës

